



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti mujor – nëntor 2007

Mos informimi lidhur me deklarin mbi fajësi përbën shkelje të ligjit vendor

OSBE është e brengosur se të pandehurit janë dënuar mbi baza të pranimit të fajësisë edhe pse gjyqtarët nuk i kishin informuar ata paraprakisht për pasojat e një pranimi të tillë.

Kodi i Përkohshëm i Kosovës i Procedurës Penale (“Kodi i Procedurës Penale”)¹ I lejon të pandehurit të pranoj fajësinë për akuzat penale,² për shpërblim me dënim më të butë.³ Në raste të tilla, shqyrtimi kryesor nuk mbahet dhe procedura vazhdon drejtpërdrejtë me fjalimet përfundimtare të palëve.⁴

Duke pasur parasysh pasojat serioze të pranimit të fajësisë, ligji parasheh garanci për të pandehurin i cili vendos të pranoj fajësinë. Në veçanti, gjyqtari ka për detyrë të sigurojë se: (1) i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; dhe (2) pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin mbrojtës, nëse i pandehuri është i përfaqësuar nga mbrojtësi.⁵

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka monitoruar raste në të cilat gjykata kishte pranuar deklarin mbi të fajësisë nga i pandehuri i cili nuk ishte informuar mbi pasojat e një deklarimi të tillë.

Në një rast para një gjykate komunale, më 18 tetor 2007 i pandehuri u deklarua fajtor për akuzë të dëmtimit të pronës së luajtshme,⁶ për shkak se kinse pa qëllim kishte thyer dritaren e një veture të parkuar në rrugë. Gjyqtari dështoi ta informojë të pandehurin -- i cili nuk kishte përfaqësim ligjor -- mbi pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata pastaj e dënoi të pandehurin me gjobë prej 150 Euro.⁷

Rasti i dytë para një gjykate komunale, përfshin procedurë të shkurtër për veprën e pandehur penale të kalimit të paautorizuar të kufirit.⁸ Në këtë rast, në fillim të shqyrtimit kryesor më 16 shkurt 2007, gjyqtari pyeti dy të pandehurit nëse ata kishin kryer veprat e përshkruara në propozim akuzë. Pasi ata pohuan

¹ Kodi i Përkohshëm i Kosovës i Procedurës Penale, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003.

² Neni 359(2) dhe Neni 315(1), Kodi i Procedurës Penale.

³ Shih nenin 64(1) dhe 70(3) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (“Kodi Penal”), i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003.

⁴ Neni 359(5), Kodi i Procedurës Penale.

⁵ Gjyqtari gjithashtu duhet të përcaktojë se a: (a) është vepra me të cilën ai ngarkohet vepër penale; (b) pranimi i fajësisë mbështetet me faktet e rastit; (c) nuk ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale; (d) afati i kufizimit të parashikuar me statut nuk ka kaluar; dhe (e) ka një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale (shih nenin 315, lidhur me nenin 316, të Kodit të Procedurës Penale). Shih gjithashtu nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, me anë të të cilit gjykata ka për detyrë t’i informojë të pandehurit lidhur me të drejtat e tyre.

⁶ Neni 260(1), Kodi Penal.

⁷ Si shqetësim më i madh, veprimet e pandehura në aktakuzë nuk përbëjnë vepër penale. Një person është fajtor për vepër penale të dëmtimit të pronës së luajtshme vetëm nëse ai ka vepruar qëllimisht (shih nenin 11(3) dhe 260(1), Kodi Penal). Duke dënuar të pandehurin për veprim i cili nuk përbën vepër penale, siç ka nënvizuar së fundi OSBE (shih Raportin Mujor të Seksionit për Monitorim të Sistemit Ligjor të Misionit të OSBE-së në Kosovë, shtator 2007) është shkelje e parimit *nullum crimen sine lege* (shih nenin 1(2), Kodi Penal, Neni 15 (1) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Neni 7 (1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

⁸ Neni 114, Kodi Penal.

këtë, gjyqtari regjistroi pranim të fajësisë në të mirë të tyre. Vetëm pas kësaj gjyqtari i njoftoi të pandehurit lidhur me pasojat e deklaratave të tyre dhe i lejoi të konsultohen me mbrojtësit e vet. Gjykata menjëherë i dënoi të pandehurit me 15 ditë burg.

Në rastet e përshkuara më lartë, gjykatat dënuan të pandehurit duke u bazuar në pranimin e fajësisë edhe pse ata nuk ishin njoftuar paraprakisht me pasojat e pranimin të fajësisë dhe nuk kishin konsultuar avokatët e tyre mbrojtës. Pranimi i fajësisë pa informim është legalisht i pavlefshëm.⁹ Rrjedhimisht, aktgjykimi i bazuar në një deklaram të tillë është i pavlefshëm, dhe ndaj tij duhet të parashtrahet ankesë bazuar në nenin 403(2) të Kodit të Procedurës Penale.

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon:

- Gjyqtarët gjithmonë duhen të njoftojnë të pandehurit lidhur me pasojat e pranimin të fajësisë, para se të kërkojnë nga të pandehurit të pranojnë fajësinë.
- Gjyqtarët duhen t'i inkurajojnë të pandehurit që të konsultojnë avokatët mbrojtës para se të deklarohen fajtorë.
- Avokatët duhet të parashtrojnë ankesë kundër aktgjykimeve të bazuara në pranime të fajësisë të cilat sipas procedurës janë të pavlefshme.

Dështimi i gjykatave për të ftuar në mënyrë të duhur palët ose dëshmitarët mund të qoj në vonesa të pajustificueshme në procedurat e gjykimeve civile

OSBE është e brengosur se vonesat të cilat rezultojnë nga shtyrjet e përsëritura të gjykimeve civile mund të pengojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe të shkel të drejtat e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme.¹⁰

E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme është e paraparë në garancinë e të drejtës për gjykim korrekt. (Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), e cila është gjithashtu e zbatueshme në procedurën civile.¹¹ Në përcaktimin se çka përbën "kohë të arsyeshme" për qëllime të nenit 6 të Konventës, vëmendja duhet të përqendrohet në rrethanat e secilit rast. Kjo përfshin ndërlikueshërinë e çështjeve ligjore ose faktike të dala nga rasti, sjellja e paditësit dhe e shtetit.¹² Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktoi se shtetet duhen të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që t'i lejojnë gjykatat t'i zbatojnë dispozitat e nenit 6 të Konventës.¹³

⁹Shih nenin 315(4) dhe 359(4), Kodi i Procedurës Penale. Natyrisht, pranimi i fajësisë është gjithashtu i pavlefshëm në qoftë se prokurori nuk i përcakton të gjitha elementet e kërkuara ligjore për vepër penale ose nëse veprimet e pandehura në aktakuzë nuk përbëjnë vepër penale.

¹⁰ OSBE më parë ka raportuar lidhur me problemet që kanë të bëjnë me ftesat e dëshmitarëve si në procedurë civile ashtu edhe në atë penale. Shih Raportet e OSBE-së: *Raporti mujor Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit* (shkurt 2005) dhe *Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale* (mars 2004), fq.15. Përkundër këtyre raporteve, vonesat që rezultojnë nga problemet lidhur me ftesën e dëshmitarëve ende vazhdojnë në Kosovë.

¹¹ Shih aktgjykimin *Moreira v Portugal*, Nr. 11371/85, 26 tetor 1988, para. 46.

¹² Aktgjykim *Pailot v France*, Nr. 32217/96, 22 prill 1998, para. 61.

¹³ Aktgjykim, *Muti v Italy*, Nr. 14146/88, 23 mars 1994, para. 15; Aktgjykim, *Sussmann v Germany*, Nr. 20024/92, 16 shtator 1996, paragrafët 55 -56.

Ligji i procedurës civile i zbatueshëm në Kosovë përcakton se fletëthirrjet gjyqësore normalisht duhet të dërgohem me postë, por se ato gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes anëtarit të caktuar të personelit gjyqësor (korrieri gjyqësor), përmes komunës kompetente ose drejtpërdrejtë në gjykatë.¹⁴ Nëse personi i cili duhet të ftohet nuk gjendet në adresën e tij/saj, ftesa mund t'i dorëzohet ndonjë anëtarit të rritur të familjes ose personave të tjerë siç mund të jetë kujdestari i shtëpisë ose fqinjët.¹⁵ Dëftesa e fletëthirrjes duhet të nënshkruhet si nga marrësi ashtu edhe nga dërguesi.¹⁶ Për më tepër, nëse paditësi nuk mund të përcaktoj adresën e të paditurit “[...] gjykata duhet të mundohet të merr informatat e caktuara nga organi kompetent administrativ, ose të merr informatat e duhura në ndonjë tjetër mënyrë”.¹⁷

OSBE ka monitoruar rastet civile në të cilat procedura e ftesës për gjykatë nuk ishte efikase dhe kështu rezultoi në vonesa të procedurës. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Në një rast para një gjykate komunale paditësi parashtrroi një padi për kompensim dëmi më 24 prill 2002. Gjykata shtyu seancat e caktuara gjyqësore shtatë herë¹⁸ sepse në shkresat e lëndës nuk kishte dëshmi lidhur me atë se a ishin palët të ftuar në mënyrë të rregullt.¹⁹ Rasti është ende në procedim.²⁰

Në një padi të datës 28 dhjetor 2005 pranë një gjykate komunale, me të cilën paditësi kërkonte dëbimin e të paditurit nga dyqani i tij, seanca e parë gjyqësore u mbajt më 2 maj 2006. Më pas, gjykata shtyu tri seanca mbi bazat në vijim: dështimi për t'i ftuar dëshmitarët e propozuar (3 gusht 2006); dështimi për të ftuar të paditurin (më 24 nëntor 2006);²¹ dhe dërgimi jo-korrekt i fletëthirrjes për

¹⁴ Shih nenin 133 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77–1478, 36/80–1182, 69/82-1596).

¹⁵ Shih nenin 141 dhe 142 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Neni 142 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore në mënyrë eksplicite veçon se cilat dokumente duhen t'i dorëzohen palëve personalisht. Pasi që fletëthirrjet gjyqësore janë të përfshyera në këtë nen, dorëzimi personal nuk kërkohet dhe ftesa mund t'i dorëzohet ndonjë anëtarit të rritur të familjes ose personave të tjerë siç mund të jetë kujdestari i shtëpisë ose fqinjët, siç është paraparë me nenin 141 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Ky nen thotë “nëse askush nuk gjendet në banesë, ftesa do t'i dorëzohet kujdestarit të banesës ose fqinjët, nëse ata pajtohen ta pranojnë”. Shih gjithashtu nenet 144 dhe 145 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, të cilat rregullojnë situatat tjera përjashtimore siç është refuzimi për pranim ose ndryshimi i adresës.

¹⁶ Shih nenin 149 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, i cili përcakton se “[n]ëse marrësi refuzon të nënshkruaj dëshminë e dërgesës, dërguesi do ta shënoj këtë [...] dhe të shkruaj datën e dërgesës në letër, dhe duke bërë këtë, dërgesa konsiderohet e kryer. [...] Kur, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dërgesa i është dorëzuar ndonjë personi tjetër në vend të atij të cilit është dashur t'i dorëzohet, dërguesi do të shënoj marrëdhënien midis këtyre dy personave në dëshminë mbi dërgesë.”

¹⁷ Neni 148 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁸ Gjykata shtyu seancat më 2 korrik 2003, 21 tetor 2003, 19 nëntor 2003, 17 dhjetor 2003, 26 mars 2004, 28 qershor 2006 dhe 18 korrik 2007.

¹⁹ Dëftesa e fletëthirrjes ishte kthyer me shënim se pala nuk është gjetur në adresë të specifikuar ose, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nuk i kishte kthyer gjyqit dëftesën e fletëthirrjes para seancës së caktuar.

²⁰ Gjykata gjithashtu shtyu seancat e gjyqit për arsye tjera nga ajo e dështimit për t'i ftuar palët ose dëshmitarët. Për shembull, gjykata ri-caktoi gjykimin më 2 nëntor 2004, 1 mars 2005 dhe 23 mars 2005 sepse i padituri nuk u paraqit (edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt) dhe më 19 janar 2006 sepse ekspertit nuk e parashtrroi raportin e kërkuar.

²¹ Fletëthirrja i ishte kthyer gjykatës, ku shkruante se adresa e të pandehurit nuk është e ditur e as e njafueshme, edhe pse gjykata e kishte ftuar të paditurin po në atë adresë për seancat e mëparshme.

dëshmitarë në zyrën kadastrale në vend të Drejtoratit për Urbanizëm (23 janar 2007).

Të dy shembujt demonstrojnë mungesën e efikasitetit lidhur me thirrjen e palëve që rezultuan me vonesa të procedurës. Edhe pse rasti i parë nuk përfshin çështje të ndërlikuara ligjore ose faktike, ende mbetet i pakryer në gjykatë për më shumë se pesë vjet. Problemet lidhur me dërgimin e fletëthirrjeve gjithashtu shkaktuan vonesa të panevojshme në rastin e dytë. Këto vonesa ndikuan në të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme për shkak se autoritetet relevante dështuan të organizojnë një sistem efikas për t'i ftuar palët.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që:

- Gjykatat duhen të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar që autoritetet relevante të përfillin procedurën e thirrjes së palëve.
- Kryetarët e gjykatave dhe Drejtori i Post-telekomunikacionit të Kosovës duhen të sigurojnë se korrierët e gjykatës dhe punëtorët e shërbimit postar të përcjellin trajnime adekuate lidhur me procedurat e thirrjes së palëve siç është përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore.
- Gjykatat duhen t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për t'i alokuar adresat e sakta të palëve dhe dëshmitarëve në qoftë se paditësi nuk ka mundësi që ta ofroj adresën e saktë.²²

²² OSBE më parë ka raportuar se bazuar në Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2002/16 i cili implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/13 mbi Regjistrin Civil Qendror, autoritetet juridike të UNMIK-ut mund të kërkojnë nga Regjistri Civil zbulimin e të dhënave personale, dhe gjykatat mund t'i shfrytëzojnë këto informacione për t'i gjetur personat. Shih raportin e OSBE-së *Administrim i Drejtësisë në Gjykatat Komunale* (mars 2004), faqe 15.